

Plani arsimor, për trajnimin e personelit ushtarak dhe civil, në kuadër të programit IMET, për vitin fiskal 2015.

WCNs	Titulli I Kursit	Periodha	Pershkrimi I Kursit	Kriteret	Afati
1003	Army War College/Kolegji i Luftës i FT.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi do ti ofrojë kandidatit mundësinë për të studiuar rolin e forcave tokësore si pjesë e një komande të bashkuar ose force shumëkombëshe. Përgatitja e liderëve ushtarakë për marrjen e përgjegjësi drejtuese në një ambient të sigurisë strategjike në kohë paqe ose lufte. Kurrikulumi fokusohet në çështje e koncepte të strategjisë së sigurisë kombëtare, strategjisë ushtarake, planeve dhe operacioneve në skenën e luftimit si dhe konceptet e drejtimit dhe menaxhimit.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →N/kolonel-Kolonel; 16-23 vjet në shërbim aktiv; Kandidat që synohet të jetë i përzgjedhur për të vazhduar karrierën në FA; Të ketë përfunduar Kursin e Komandës dhe Shtabit.	26 Shtator 2014
1007	Command and General Staff College/Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Studimet do të përfshijnë pjesën bazë kursin mbi operacionet e avancuara luftarake si dhe lëndët me zgjedhje. Studentët do të marrin informacion mbi:- aktorët që veprojnë në një ambient të caktuar dhe bashkëpunimin midis tyre, kuptimin dhe analizimin e koncepteve doktrinale e problemeve ushtarake në nivel strategjik e operacional. Konceptet dhe parimet që aplikohen te njësitë taktike në të gjithë spektrin e kryerjes së operacionit.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Kapiten-Major; Të kenë kryer detyra komanduesenë nivel kompanie; Të ketë përfunduar Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit, në Akademinë e Mbrojtjes ose një kurs ekuivalent jashtë shtetit.	26 Shtator 2014
1009					
2510	SR INTERNATIONAL DEF MGT CRS/Kursi i Lartë Ndërkombëtar i Menaxhimit të Mbrojtjes	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi është dizenuar për nivelet e larta drejtuese, personel i cili mbulon fushat e planifikimit strategjik dhe ekonomik, shpërndarjen efektive dhe përdorimin me efizienz të materialeve dhe burimeve të tepërta të mbrojtjes, në një ambient sigurisë kompleks dhe të pasigurtë. Pjesëmarrja përfshin një spektër të gjerë veprimi si: logjistikë, operacione, personel, blerjet, menaxhim financiar, menaxhim programesh, planifikim, inxhinieri dhe vlerësim të programeve.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Gjeneral Brigade e lartë/ Civil Ekuivalent; Të tjera → Pjesëmarrësit duhet të punojnë në nivelet e larta të vendimmarrjes dhe të jenë të fokusuar në aspektet strategjike planifikimin e mbrojtjes dhe shpërndarjen e burimeve të mbrojtjes.	26 Shtator 2014
2511					
2501	INTL DEF MGT CRS/Kursi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Mbrojtjes.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi integron konceptet analitike, parimet, metodat dhe teknikat të dala nga disiplina e menaxhimit, ekonomisë dhe spjegon aplikimin e tyre në procesin e vendim-marrjeve në ndarjen e burimeve financiare, logjistike dhe njerëzore. Kurrikula e kursit përfshin një spektër të gjerë veprimi si: logjistikë, operacione, personel, blerjet, menaxhim financiar, menaxhim programesh, planifikim, inxhinieri dhe vlerësim të programeve.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Major – Kolonel/ Civil Ekuivalent; Kandidatet duhet të mbulojnë fushat e planifikimit, menaxhimit, logjistikes dhe personelit.	26 Shtator 2014
2502					
2503					
2504					
1101	MANEUVER CCC/Kursi i Kapitenit të Karrierës të Këmbësorisë.	19-Maj-04-Dhjetor-2015	Përshkrimi: Kursi është projektuar për togerë dhe kapitenë të rinj për të shërbyer në pozicionet e komandantit të kompanisë dhe oficerit të shtabit në batalione. Kursi është i ndarë në tre faza: Faza e parë trajnim/administrim; Faza e dytënë nivel kompanie; Faza e tretë në nivel batalioni.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger -Kapiten; Të mos ketë përfunduar KTHOSH; Certifikatë sigurie niveli "Sekret"	26 Shtator 2014
1103		29-Dhjetor-14-15-Korrik-15			25 Korrik 2014
1105		23-Mars-08-Tetor-15			26 Shtator 2014
1107		29-Dhjetor-14-15-Korrik-15			25 Korrik 2014
1201	Infantry BOLC/Kursi Bazë i Oficerit të Këmbësorisë.	29-Dhjetor-14-05-Maj-15	Përshkrimi: Kursi është përshtatshëm për oficerë të cilët shërbejnë në detyrat e komandantit të togës, oficer ekzekutiv kompanie. Kursi ofron njohuri mbi taktikën e përdorimit të armëve (doktrina taktike dhe operacione), aktivitete shtabi (zbulimi, logjistika, menaxhimi i stërviçjes), tema të përgjithshme (drejtimi ushtarak) ndërlihdje, elektronikë etj. Kursi fokusohet në anën taktike dhe aspektet e lidshmit të oficerëve të rinj dhe më pak në anën administrative. Pjesa më e madhe e kohëzgjatjes së kursit zhvillohet në terren. Gjithashtu kandidati do të marrë njohuri mbi armatimin e lehtë që përdoret në togën e këmbësorisë së ushtrisë amerikane.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada → N/toger-Toger; Të tjera → Kursi nuk është i aplikueshëm për kandidatet femra; Kandidatët të jenë të përgatitur për përballimin e ngarkesës fizike.	25 Korrik 2014
1203		11-Maj-16-Shtator-2015			26 Shtator 2014
1205		10-Gusht-17-Dhjetor-2015			26 Shtator 2014
1211		29-Qershor-03-Nentor-2015			25 Korrik 2014

Shënim: Të gjitha propozimet duhet të shoqërohen me CV, përshkrim pune dhe formular me të dhënat personale, në gjuhën angleze, sipas formatit të kërkuar, si dhe fotokopje pasaporte.

Plani arsimor, për trajnimin e personelit ushtarak dhe civil, në kuadër të programit IMET, për vitin fiskal 2015.

WCNs	Titulli i Kursit	Periodha	Pershkrimi i Kursit	Kriteret	Afati
1139	SIGNAL CCC/Kursi i Kapitenit të Karrierës për Ndërlidhjen.	27-Janar-24-Qershor-15	Përshkrimi: Kursi do të ofrojë për studentët njohuri për doktrinën operacionale, planifikimin e sistemeve të komunikimit, inxhinierinë e rrjeteve të komunikimit analoge dhe dixhitale, luftën elektronike, automatizimin, drejtimin dhe lidhshirimin, administrimin e personelit, menaxhimin e stërvitjes, sistemet taktike të sinjalizimit, doktrina etj.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger -Kapiten; Të mos ketë përfunduar KTHOSH; Certifikatë sigurie niveli "Sekret".	26 Shtator 2014
1135	MIL POL CCC/Kursi i Kapitenit të Karrierës të Oficerit të Policisë Ushtarake.	12-Janar-26-Qershor-15	Përshkrimi: Kursi fokusohet në zgjerimin dhe zhvillimin e vlerave profesionale si njohuritë drejtuese, taktike dhe teknike, etika ushtarake. Kursi përfshin trajnimin mbështetur në disa fusha kryesore si: dimensionimi human, sjellja, puna në grup dhe udhëheqja.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger -Kapiten; Të mos ketë përfunduar KTHOSH; Certifikatë sigurie niveli "Sekret".	25 Korrik 2014
1215	MIL INTEL BOLC/Kursi Bazë i Zbulimit Ushtarak.	30-Dhjetor-14-05-Maj-15	Përshkrimi: Kursi ofron njohuri dhe aftësi bazë, të gjithë informacionin që i nevojitet një oficeri zbulimi në nivel taktik, si dhe njohurit dhe aftësitë që zotëron një oficer zbulimi në rolin e komandantit të togës . Kurrikula e kursit përfshin tema si: kërcënime të kundërshtarit, menaxhimin e programit të stërvitjes së njësisë, sulmet elektronike, shërbimi inteligjent njerëzor, shërbimi inteligjent i ndërlidhjes, shërbimi inteligjent imazherik, mbështetja në operacioneve, kundërzbulim dhe shërbimi inteligjent në nivel taktik duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion.	Niveli i gjuhës → anglisht 70 pikë; Grada → N/toger- Toger; Të tjera → Certifikatë sigurie niveli "B";	25 Korrik 2014
1131	COMB LOG CCC/Kursi i Kapitenit të Karrierës për Logjistikën.	02-Shkurt-22-Korrik-15	Përshkrimi: Kursi është projektuar për togerë, për të shërbyer si oficerë shtabi në një shtab shumëkombësh. Kursi do të pajisë oficerët me njohuri mbi funksionet e logjistikës dhe mbështetjen logjistike në operacione.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger -Kapiten; Të mos ketë përfunduar KTHOSH; Certifikatë sigurie niveli "Sekret"	26 Shtator 2014
1207	TRANSP BASIC OFF LEADER CRS/Kursi Bazë i Oficerit të Transportit.	19-Janar-14-Maj-15	Përshkrimi:Kursi është i orientuar drejt maksimalizimit të trajnimit praktik, nëpërmjet objektivave të strukturuar mbi performancën, me instruktime teorike minimale mbi çështjet e dislokimit të forcës, shpërndarjen e sinkronizuar, rrjetin e transportimit të bashkuar, transportimi detar/ajror, lëvizja e personelit dhe materialeve.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →N/toger-Toger; Të tjera → Të aftë fizikisht në gjendje për të përballuar ngarkesa fizike;	25 Korrik 2014
1213	ORDINANCE BASIC LEADER OFF CRS/Kursi Bazë i Oficerit Ordiancë.	29-Dhjetor-14-01-Maj-15	Përshkrimi:Kursi ofron për pjesëmarrësit njohuri në: drejtim dhe udhëheqje, taktik dhe mbrojtjen e njësisë, menaxhimin e mbështetjes dhe furnizimit të njësisë, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e njësisë, menaxhimin e materialeve dhe municioneve.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger; Të jetë oficer i specialitetit Furnizim, Mirëmbajtje ose Armatim-Municion.	25 Korrik 2014
1001	INTL MARITIME OFF	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi i jep mundësinë studentëve për të studiuar organizimin ushtarak, planëzimin, menaxhimin dhe operacionet shumëpolëshe të Forcave Detare. Tematika kryesore e kursit përfshin çështjet e kërkimit shpëtimor, zbatimit të ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar në det, drejtimi dhe trajnimi aspektet ligjore ndërkombëtare në det etj.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Lejtnant-Kapiten Lejtnant; Të jetë me detyrë komandant në anijet e Rojës Bregdetare.	26 Shtator 2014
1002	(IMOC)/Kursi Ndërkombëtar i Oficerit Detar.				
1003					
6001	Basic American Language Instructor Course (BALIC)/Kursi baze i instruktorit të gjuhës.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi është ndërtuar për personel që ka për objekt të punës së vet administrimin e gjuhës angleze. Kursi do të japë njohuri mbi administrimin menaxhimin dhe kontrollin e Programit të Trajnimit të Gjuhës Angleze (ELTP). Theksi do të vendoset kryesisht mbi aspektet praktike të menaxhimit të programit.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → e pa përcaktuar, këshillohet të jetë Ushtar Profesional ose nënoficer që zotëron një diplomë universitare.	26 Shtator 2014
6002					
6004					
6011	Management English Language Training (MELT)/Kursi mbi Menaxhimin e Trajnimit në Gjuhën Angleze.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi është dizajnuar për ngritjen e aftësive menaxhuese, administrative dhe organizative. Kursi ofron njohuri bazë në të gjitha fushat të cilat lidhen me administrimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit në gjuhën angleze. Fokusi kryesor i këtij kursi bie mbi praktikizimin në menaxhimin e trajnimeve në gjuhën angleze duke bërë një ndërthurje të mësimve teorike me ato praktike.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → e pa përcaktuar Të tjera → komanda e cila propozon kandidatura të planëzojë angazhimin e personit të trajnuar në rolin e Instruktorit të Gjuhës Angleze, për një periudhë jo më pak se dy vjet, që nga data e përfundimit të kursit.	26 Shtator 2014

Shënim: Të gjitha propozimet duhet të shoqërohen me CV, përshkrim pune dhe formular me të dhënat personale, në gjuhën angleze, sipas formatit të kërkuar, si dhe fotokopje pasaporte.

Plani arsimor, për trajnimin e personelit ushtarak dhe civil, në kuadër të programit IMET, për vitin fiskal 2015.

WCNs	Titulli I Kursit	Periudha	Pershkrimi I Kursit	Kriteret	Afati
6001	RANGER.	10-Prill-10-Korrik-15	Përshkrimi: Kursi konsiston në tre faza. Faza e parë (fillestare) zhvillohet në Fort Benning, Georgia dhe zgjat 20 ditë. Faza e dytë (mal) zhvillohet në afërsi të Dahlonge në malet e Georgia-s veriore dhe zgjat 21 ditë. Faza e tretë (xhungël dhe zonë urbane) zhvillohet në Bazën Ajrore Eglin në Florida dhe zgjat 18 ditë. Ky kurs ka për qëllim përgatitjen e trupave elitare, të afta për kryerjen e veprimeve taktike operacionale në kushte të ndryshme të skenës së luftimit.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → e pa-përcaktuar; Të tjera → të aftë fizikisht për të përballuar ngarkesë fizike. Kandidaturat do t'i nënshtrohen testeve fizike.	26 Shtator 2014
6005		2015, e papërcaktuar.			
2000	Officer Candidate School/Sjkolla e kandidatëve për oficerë.	2015, e papërcaktuar.	Kandidatët e interesuar të paraqiten pranë Qendrës së Personel Rekrutimit për aplikim. Niveli gjuhësor prej 75 pikë, është niveli i kërkuar për ndjekjen e "Shkollës së kandidatëve për oficerë. Kandidatët e interesuar, por që nuk plotësojnë kriterin gjuhësor, mund të aplikojnë dhe njkohësisht të punojnë për rritjen e kapaciteteve gjuhësore.	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada → e pa-përcaktuar (nënoficerë dhe ushtarë profesionistë; Moshë → Jo më shumë se 26 vjeç, deri më datë 31 Korrik 2014. Të tjera → Të zotë rojnë diplomë universitare "Bachelor" të nivelit të parë, të kenë përfunduar SIB dhe SIA, të aftë fizikisht për të përballuar ngarkesë fizike. Kandidaturat do t'i nënshtrohen një procesi trajnimi parapërgatitor dhe testeve fizike dhe gjuhësore.	29 Gusht 2014
2001					
2002					
2003					
2004					
2005					
1005	National War College (NWC INTL Fellowship Program)/Kolegji Kombëtar i Luftës.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Misioni i Kolegjit Kombëtar të Luftës është të përgatisë liderët e ardhshëm të Forcave të Armatosura, mbi politikën e nivelit të lartë, komandën dhe detyrat të shtabit duke marrë pjesë në një kurs të nivelit të lartë në studime të strategjisë së sigurisë kombëtare dhe politikën kombëtare të sigurisë dhe të operacioneve. Kurrikula fokusohet në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar në të cilin zhvillohet strategjia e sigurisë Kombëtare, strukturat e sigurisë kombëtare dhe procesi i vendimmarrjes, formulimi dhe implementimi i strategjisë ushtarake. Programi i Kolegjit thekson bashkimin e planifikimit të operacioneve dhe ndërveprimin e politikave kombëtare, të huaja si dhe politikën e mbrojtjes. Garda e përshatshme për ndjekjen e këtij kursi është Kolonel ose Civil ekuivalente mbi 15 vjet eksperiencë pune. Është e këshillueshme pasja e një diplome universiteti pasi ky program të ofron diplomë të nivelit master. Për tu kualifikuar për diplomën e nivelit master pjesëmarrësit duhet të plotësojnë një sërë kërkesash të cilat do t'i bëhen të ditura kandidatit të përzgjedhur.	Niveli i gjuhës → 80 pikë; Grada → Kolonel/ Gjeneral Brigade; Të ketë niveli të larta dhe eksperiencë në detyra komanduese ose shtabi; Të ketë mbi 15 vjet punë.	26 Shtator 2014
2505	DEF ACQUISITION MGMT/Kursi i Menaxhimit të Blerjeve të Mbrojtjes.	2015, e papërcaktuar.	Kursi u jep studentëve kuptimin mbi konceptet, parimet thelbësore dhe filozofinë e procesit të menaxhimit të blerjeve të mbrojtjes, si dhe aplikimin praktik të metodave të menaxhimit të programit. Kursi prek çështjet e karakteristikave të menaxhimit dhe kompetencave, politikën e kontrollit dhe teknikat, metodat e analizës së sistemit, menaxhimin e rrezikut. Në veçanti do të trajtohen statusi aktual i politikave të blerjeve të mbrojtjes dhe praktikave të menaxhimit jetësor të blerjeve, planifikimin implementimin dhe menaxhimin financiar. Disiplinat e blerjeve, kontratave, logjistikës dhe planifikim programimin.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada: - Major-Kolonel/ Civil Ekuivalent.	26 Shtator 2014
1137	INTL Officer Intel CCC/Kursi i kapitenit të karrieres, i zbulimit.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi është i ndarë në faza dhe përfshin dhënie të njohurive për mbështetjen me zbulim në operacionet e batalionit, brigadës dhe operacionet e bashkuara. Theksi vendoset në përgatitjen e studentit për të shërbyer në detyrën e komandantit të kompanisë ose detyra në shtab të një niveli me të lartë.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Të mos ketë përfunduar KTHOSHGrada →Toger - Kapiten; Certifikatë sigurie niveli "Sekret".	29 Gusht 2014

Plani arsimor, për trajnimin e personelit ushtarak dhe civil, në kuadër të programit IMET, për vitin fiskal 2015.

WCNs	Titulli I Kursit	Periodha	Pershkrimi I Kursit	Kriteret	Afati
1301	US SERGEANTS MAJOR ACADEMY/Kursi i Krye-Kapterit.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi është i përshtatshëm për Nënoficerët me gradën Kapter. Kandidaturat duhet të kenë gjendje të mirë fizike. Kandidaturat për ndjekjen e këtij kursi do të ndjekin një kurs përgatitor 4 javor dhe më pas do ndjekin kursin e Krye-Kapterit. Periudha përgatitore do t'i shërbejë kursantit për tu familjarizuar me historinë, kulturën me doktrinën dhe stërvitjen ushtarake, strukturën dhe organizimin komandues etj.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Rreshter-Kapter. Të tjera → Tëjetë personel i cili mendohet të promovohet në kraden e kryekapterit.	26 Shtator 2014
1505	Infantry Man Advanced Leader Course(BNCOC)/Kursi i Avancuar i N/Oficierit të Këmbësisë.	2015, e papërcaktuar.	Përshkrimi: Kursi zhvillohet në dy faza. Faza e parë konsiston në orientimi me anë të hartës (ditën dhe natën), trajnim në simulator virtual, trajnim të avancuar për qitje me armët e këmbësisë, trajnim për përdorimin taktik të mitralozit, trajnim mbi procedurat e vëzhguesit të përparuar dhe procedura të tjera. Në fazën e dytë zhvillohet trajnim për zërvitje operacionale fushore, veprime taktike në nivel skuadre dhe asgjësimi i municioneve.	Gjuha angleze → 70 pikë; Grada → Tetar-Rreshter; I aftë për përballimin e ngarkesave fizike.	29 Gusht 2014

Kandidatet te cilet mendojne se plotesojne kriteret per ndjekjen e ketyre kurseve te ndjekin linjen e komandimit dhe nepermjet degeve te personelit te reparteve perkatese te sjellin propozimet ne Drejtorine e Arsimit dhe Perkuqdesjes Sociale te Ushtarakeve.

* **Datat dhe kurset e ofruara do të jenë objekt ndryshimi.**